



Financuar nga
Bashkimi Evropian



AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK



PLAFTORMA E PARTNERITETIT PËR INTEGRIMIN EUROPIAN & KONVENTA KOMBËTARE PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Situata e Kapitullit 5 në procesin e negociatave: Përmbushja e piketave mbyllëse
E premte, 27 shkurt 2026, 10:00 – 12:00

REKOMANDIME

Agjencia e Prokurimit Publik dhe Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) organizuan një tryezë diskutimi e cila u fokusua kryesisht në gjendjen aktuale të progresit të Kapitullit 5 – Prokurimi Publik, përmbushjen e piketave të përkohshme përmbyllëse, në kuadër të procesit të negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në BE, dhe hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit 2026-2030 për Partneritetin e Qeverisjes së Hapur (OGP). U prezantua gjithashtu edhe metodologjia për vlerësimin e riskut të korrupsionit në prokurimin publik, e hartuar në partneritet me Autoritetin Italian Kundër Korrupsionit (ANAC), Ministrin e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin (MAPA) dhe me mbështetjen e OSBE-së.

Gjatë diskutimeve me përfaqësues të shoqërisë civile, akademikë dhe aktorë të tjerë të përfshirë në fushën e prokurimit publik, u sollën në vëmendje pikat e mëposhtme:

1. Duke iu referuar praktikës së ndjekur nga Komisioni i Prokurimit Publik në lidhje me mospranimin e ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë përpara publikimit të njoftimit të fituesit në Buletinin e Njoftimeve Publike të Agjencisë së Prokurimit Publik, për shkak të afatit të përcaktuar në ligj dhe të faktit që autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës, lind nevoja për një qartësim më të thelluar të kësaj praktike. Edhe pse respektimi i afateve procedurale është thelbësor për garantimin e sigurisë juridike dhe për mbarëvajtjen e procesit të prokurimit, një qasje tepër formale gjatë fazës së vlerësimit *prima facie* të ankimit mund të ndikojë negativisht në efektivitetin real të mjeteve juridike administrative. Kjo bëhet veçanërisht problematike në rastet kur një operator ekonomik skualifikohet mbi bazën e arsytimit të paqarta apo të pamjaftueshme, duke kufizuar në praktikë mundësinë për të ushtruar të drejtën e ankimit në mënyrë të plotë dhe efektive.

*Tryezat e Diskutimit dhe Këshillimit për Kapitullin 5 organizohen në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.113, datë 30.08.2019 “Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin Europian”.

*Kjo tryezë u zhvillua në kuadër të projektit “Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimin në BE”, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian – IPA Civil Society Facility 2021, i cili zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Akademinë e Integrimit Europian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI).



Financuar nga
Bashkimi Evropian



AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK



2. Në kushtet e mësipërme, rekomandohet gjithashtu vendosja e një standardi komunikimi institucional me operatorët ekonomikë, veçanërisht në fazat që lidhen me afatet e ankimit dhe refuzimin procedural të kërkesave. Përveç publikimit formal të afateve në dokumentacionin e tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik duhet të garantojnë një informim të qartë dhe hap pas hapi kur operatori ekonomik mund të ushtrojë sërish të drejtën e tij, fillimin e afatit ligjor të ankimit, si dhe mbi periudhën brenda së cilës ankesa do të shqyrtohet. Një praktikë e tillë do të siguronte transparencë, do të shmangte refuzimet për arsye formale dhe do të garantonte që ankesa të mund të shqyrtohet në thelb.
3. Procesi i profesionalizimit të specialistëve të prokurimit përbën një nga masat më të rëndësishme në forcimin e kapaciteteve institucionale. Megjithatë, për të garantuar efektivitetin real të saj, rekomandohet që përmbajtja e testimeve të pasqyrojë më gjerësisht kompleksitetin praktik të procedurave. Aktualisht, një pjesë e konsiderueshme e aktivitetit prokurues përbëhet nga procedura me vlerë të vogël, të cilat shpesh paraqesin sfida specifike. Përfshirja sistematike e rasteve konkrete nga këto kategori do të siguronte që testimi të mos mbetet në nivel teorik apo të kufizohet vetëm në procedura me vlerë të lartë.

*Tryezat e Diskutimit dhe Këshillimit për Kapitullin 5 organizohen në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.113, datë 30.08.2019 “Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian”.

*Kjo tryezë u zhvillua në kuadër të projektit “Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE”, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian – IPA Civil Society Facility 2021, i cili zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Akademinë e Integritimit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI).